



HAMZA KOÇIU

*këngë  
për detin*

HAMZA KOÇIU

KËNGË  
PËR DETIN

- VJERSHA -

*[Faint, illegible text]*

~~40656~~  
13121

*[Faint, mirrored text at the bottom of the page]*

HAMZA KOÇIU

KËNGË  
PËR DETIIN

- NJËRSHË -

1967

LIBRARI  
TIRANË

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash. 2204-65

Shtyp N.I.Sh. Shtypshkronjave «Mihal Duri» — Tiranë, 1967

## ATDHEU IM

Atdheu im.  
Ky shtrati stërgjyshor  
Plot plagë mori në brinj' e kraharor,  
Por nuk u dha, qëndroi në çdo murlan  
Si karakoll vigan.

Atdheu im.  
Kjo tok' e amëshuar  
Shkëlqen, gjithnjë si yll i zjarrtë,  
Stolira ka në gush' e kraharuar;  
Thesare ka një fushë të pamatë.

Atdheun tim, këtë të shtrenjtin vis,  
Një çap i ngusht' nga armiqt' e tij e ndan,  
Por i sigurt, drejt rrugës s'tij lëviz,  
Se kazm' e pushkë në duar fort i mban!

## KËNGA IME

### I

Mbi një rrogoz më lindi nëna ime  
Dhe, që atëhere, rrodhën shumë vjet,  
Tashti i qeshur unë mbledh kujtimet  
Dhe çaj si rrymë rrugën nëpër det.

### II

Jam ëndërrtar i ditëve të bardha,  
Këngën si çajkë e përcjell larg  
E, nëse thirra: «Shokë, shpejt, u zbardha!»  
Lotë trishtimi nuk derdha në varg.

### III

Nuk më pëlqen në vjershë fjal' e madhe.  
Si deti më ngjan vargu kur gjëmon.  
Më prekin lulet, bari ndër livadhe,  
Mali me borë, lumi që vërshon.



#### IV

Dua të eci me hap më të shpejtë  
Mbi vendin tim që quhet Shqipëri,  
Në maja malesh të puthem me retë  
E të thërres: «Ja, gjeta poezi»!

#### V

Në breg i mblodha këngët; si thërrimet,  
Në detin-hekur ato morën krah  
dhe si detarët rendin ndër lundrime,  
Elikën <sup>1)</sup> këmbë, shpirt i tyre ka.

---

1) Elikë — mekanizëm me fletë që vë në lëvizje anien.

## TI TË JESH ME MUA NJË USHTARE

Pranë dua të të kem përherë  
 Jo këtu ku bëjmë brromp me birrë,  
 Por kur er' e luftësë të bjerë,  
 Ti të jesh' shenjusja më e mirë.

Dhe kur dita si natë të nxijë,  
 Ti të jesh' me mua një ushtarë,  
 Jo të përkëdhelesh si fëmijë,  
 Por mbi hasmin të shkrehësh batarë.

Mos guxo të hedhësh një hap prapa,  
 Se të vras, të quaj dezertorë,  
 Dhe nuk dua të thuash: «E ngrata,  
 Qenka fati të vdes në llogorë.»

Sikur predh' e hasmit njëzet herë  
 Të m'i presë krahët, prapseprapë  
 Do qëndroj si lisi degëprerë,  
 Dhe me dhëmbë pushkën do ta kap.

Veç në më qëlloft' ai në ballë  
 Ti në zemër ta qëllosh atë,  
 Ta qëllosh dhe mos e shuaj mallë  
 As me lot të hidhur, as me gjë.

Eja rendim nëpër malet, pyjet,  
Ti ushtare dhe unë ushtar.  
Le të zgjaten udhët gjer te yjet,  
Kur ne mbrojmë trollin shqiptar.

Le të flejmë netve-ftohtësirë  
Si dy zogj nënë kaçube;  
Le të ecim rrugës së vështirë,  
Republika roje na ka ne.



## LUNDRIM TË MBARË!

U dha alarm:

«Anijen gati për lundrim!»

Merr raport

Shoku oficer

Dhe urdhër jep.

Anija shkon drejt detit që shkëlqen,

Dhe pas' e la të artin breg.

Ja, në direk,

Krenar valon

Flamur' i komandantit tonë.

Detarët gati rrinë për luftim,

Me zjarr e flakë

Armiqt' do t'i djegin me tërbim

Mes detit të shkumëzuar që perçet, shkund.

Alarm u dha:

Sinjale, tingllime të pafund

Dhe, në atë çast, shoku komandant

Detarët përgëzon,

Anija dallgët çan

Dhe pas e la

Të kaltërin liman.

Anija detin çan me pash.

Ja, përmbi bash,  
Nga lart e kryet var,  
Ky dielli rrezear  
Kurse i liri, i yni breg  
Me mall e përshëndet:  
«Lundrim të mbar', anije, nëpër det!»

## I TILLË UNË TEK JU FSHATARË VIJ

Më jepni kosën livadhin të kosit  
Dhe kazmën dua tokën të rrëmi,  
Si bahçevan gjithë pemët t'i krasit...  
I tillë unë tek ju fshatarë vij.

Kur jam mes jush, sikur gjithnjë dëfrej.  
Këtu, në fshat, çdo gjë e njoh, më njeh,  
Zhurmën e kosës në këngë e kthej  
Gëzimi juaj, i arës seç më deh.  
Nga shpirti juaj i çiltër plot furi  
Ushqim e mjaltë të marrë vargu im,  
Të bjerë erë kripë dhe kalli,  
Të bredh un' fushës gjerë plot blerim.  
I tillë vij, gjithnjë ushtar i thjeshtë,  
Përveshur mëngët, si ju gjer në bryl  
Si bujk i mirë të rrit me duar, djersë,  
Çdo bimësi në arë dhe në pyll.

## SHKËMBIT ARBËROR

Si obelisk ngrihet këtu  
Ky shkëmb — granit,  
Ku veç shqiponjëza cqep-brisk  
Vjen e çukit,  
Si karakoll ngrihet ky shkëmbi arbëror,  
Mbi të detari jep e merr  
me semafor.  
Mbi të dhe çajkëzatë lozin  
me gëzim  
Bora dhe shiu e rrahin shkëmbin  
me furil,  
Veç val' e qet' e nanuris me dashuri.  
Qëndro krenar  
ti, shkëmb i lashtë,  
Se që këtu,  
me lembet<sup>1)</sup> dolën  
Ilirët tanë  
Në detin — blu.

---

1) Lembe — anije të kohës iliriane.

## PEIZAZH DETAR

Qesh vala detare,  
Shkumëzon e shket;  
Brigjet s'duken fare,  
Veç qiell e det.

### II

Lart, në mugëtirë,  
Jupiteri ndrin  
Dhe valëz e lirë  
Shkëlqen, farfurin.

### III

Tej shkëlqen ylberi  
Bojëz pelikan,  
Hëna vrapon territ,  
yjet i përulan.



#### IV

Në horizont të hapur  
Këng' e çajkës ndihet  
Dhe shqipja detare  
Mbi shkëmbij më krihet.

#### V

Fari ngjyrë gjelbër  
Përhap rreze, ndrit,  
Veç një yll i verbër  
Fiket në zenit.

#### VI

Lundron një anije,  
Valëve humbet,  
Brigjet s'duken fare,  
Veç qiell e det.

QË TË MOS PLAKESH TI,  
O SHQIPËRI!

Do plakemi dhe në, kur koha të na  
vijë.

Do plakemi,  
Por prapa do të lemë pavdekësinë  
Dhe veprat e rininë.

Do plakemi dhe në, por nuk do  
vdesim kurrë.

Se lulëzuam edhe të thatët drurë,  
Se ne qëndisëm një qiell me plot  
dritë

Që të vezullojë e jona Republikë.  
Dhe në ecshim ne të krrusur mbi  
bastune,

Mbi thinjat tona  
Do shpalosen të kuqtë flamure,  
Se ngritëm ne  
Një të madhe lumturi,  
Që të mos plakesh ti, o Shqipëri!

## TË DUA DET

S'dija se detar do të bëhesha unë,  
Të hasja valët me stuhi, furtunë,  
Të më shkundej gjoksi im rinor  
Përmes detit t'kripur, tallazor.  
Para detit, qiejt' shumë i desha,  
Edhe tokën q'u rrita dhe qesha,  
Dhe vogëlushen që me të lodroja;  
Desha vreshtat, arat që lëroja,  
Por tashti q'u bëra un' detar,  
Dua dhe detin ujë qelibar.  
Dua valën që puth zallet, brigjet  
Edhe farin që në ngjyra digjet.  
Kur anija lundron tej diku,  
Bregu larg... det e qiell blu,  
Dua mbrëmjet që bien mbi det,  
Kur mes valëve disku i hënës shket,  
Kur në lindje flakë skuqin retë!

## NËNDOR I MADH

Nëndor i madh!  
Sa bij në luftë për ty ranë,  
Sa gjak u derdh në male si rrëke:  
Ti je triumfi i paanë,  
Ti përtërite vitet edhe ne.  
Nëndor i madh!  
Sa plagë ti shërove nëpër zemra,  
Sa syve u dhe dritë dhe gëzim,  
Ti je për ne jeta dhe ëndrra,  
Ti rrugën na ndriçon, Nëndori im.  
Nëndor i madh!  
Ti je vullneti ynë dhe dëshira,  
Ti shekujt, perënditë i le pas.  
Ne ngrehim vepra, rritim plot filiza,  
Ne nuk pyesim për dallgë dhe tallaz.  
Nëndor i madh!  
Ne ty të ngjitim lart dhe më lart  
Ndaj çel m'e bukur çdo lule në mëngjes  
Që të shkëlqesh ndër shekuj dhe më qartë  
Un', si ushtar, të mbroj, të përshëndes!



## NË ËNDËRR

Mesnatë...

Flija mbi kuvertë,  
Gëzimi më hidhej mu në zemër,  
Si djep më tundte bot' e blertë,  
Me bijën lozja nëpër ëndërr.

Me bijën loz dhe floçkat lehtë  
Ja shpupuris, si era pyjet.  
Ajo hedh dorën mbi spaletë  
Dhe buzqeshin, me mua yjet.  
Ajo rend flutura të kapë  
Nëpër petale plot aromë  
Dhe po më ngjan se, në qiellin — napë,  
I ngul gishtërinjtë — bisk të njomë,  
Më ngjan se në gjoks një botë-këngë

Më vlon, kur vajza ka gëzim.  
Dhe syt' e saj më ndritin ëmbël,  
Si dy liqej në shpirtin tim.  
Por veç një tingull përmbi kokë  
Më tingëlloi... alarm ish.  
Që të mbroj mallin, ty, o tokë  
S'ka gjë, në gjumi sot m'u prish.

PRILIN...

40656

13121



## RINIA IME

Rinia ime kaloi te ky dhe,  
Duke u përleshur në punë me titanë  
Dhe dukë ngarë para vrullin e saj  
Nëpër kantjere të paanë.

Ajo mes veprash vezullimet ndezi  
Me muskujt edhe ballin e djersitur,  
Mbi ballin e Atdheut ka stolisur  
Fytyrën e vërtet të këtij brezi!

## STUHIA E DETIT

I rrafshët deti, fushë duket,  
Kur erë s'fryn në hapësirë  
Dhe mjegulla tretet edhe zhduket;  
Lundron anija gjith' e lirë.

Veç kur shpërthen e shfryn e marrë  
Stuhi e detit e gjëmon,  
Pulëbardhat ngrihen palë-palë  
Tallazet duken porsi hon.

E fortë është stuhi e detit,  
Çdo send e mbyt dhe e lëkund  
Dhe grryen zallet prej rëmetit,  
Dhe shkunden zallet gjer në fund.

E fortë është, miq, stuhia,  
I ngreh tallazet uragan,  
Por rrëshqet trimresha jonë, anija,  
Dhe i del detit anembanë!

## GAZMORE

Mbushur lulet plot nektar  
Bredh çairit, nëpër bar.  
Këngën marr me hopa-hop,  
Nëpër duar loz një shkop,  
Fra flokët m'i luhat,  
Shetis pyllit shpat më shpat.  
Kolovitem në një shelg.  
Qainë zhabat tei në pellg  
Ciren cinxrat cin-cin-ci.  
Ndiej plot tinguj melodi.  
Zemra digjet me plot hir,  
Tingujt derdhen në çair;  
Ëmbël, bukur djelli ngroh  
Shqerra, dhen çairit shoh,  
Që kullosin nëpër bar,  
Mbledhin fijet plot nektar.  
Një kope më tej mërzen  
Hazdi kuajt i rrëmben  
Edhe bredhin këmba-kup.  
Më qëndron një zog mbi sup.  
Ja, një mëz po hingëllin,  
Të jëmën udhës e arrin  
Lopët zegla seç i kap,  
Në burim shkojnë me vrap.

Ndaj me gaz çdo gjë sodis,  
Sajoj këngë dhe shetis.  
Muza vetëm nuk më lë,  
Këng' e re rrugës më zë,  
Ndaj këndoj me hopa-hop,  
Nëpër duar loz një shkop!



## TI DETARËVE RRUGËN U NDRIÇON

Kur i vogël isha, sa qejf t'pata,  
O Yll i Mëngjesit, porsì diell  
Dorën un' drejt teje shpesh e zgjata,  
Desha të të kapja nëpër qiell.

Dhe tashti të shoh mbi tokë, dete,  
Larg sa një grusht e mbushur me dritë,  
Ndoshta, ty të shohin gjith' planetet  
Ti ndriçon për jetën, Afërditë!

Ti detarëve rrugën u tregon,  
Porsì fari kudo nëpër det,  
Ti përjetësisht digjesh, ndriçon,  
Afërditë, ylli që s'humbet!



## KËNGË PËR DETARIN

Detar, ti erdhe nga udh' e madhe  
E detit dhe yjeve,  
Por prapa, mes dallgëve-rrëmujë,  
Që ngrihen si përbindësja me hop,  
Qëndron pa trembur shoku yt  
Dhe vrojton mbi ujë e nën ujë  
Me sy e periskop.  
Detar, ti puthe këtë breg,  
Që është i stolitur anembanë,  
Dhe thithe aromën e kësaj toke.  
Ti puthe këtë tokë të gjelbër,  
Që bukë e zemër jep  
Dhe trupin tonë ushqen me verë dhe me gjak  
Dhe dejtë tonë ushqen me trimëritë,  
Të mbjella në çdo prak.

## II

Detar,  
Sa dua me ty të lundroj,  
Mes zhegut të gushtit dhe ngricës së janarit,  
Drejt yjeve-xixëllimë;  
Dhe yjet, udhërrëfënjesit,  
T'i rrëzojmë

Mbi kreshtat e detit, që thërmohen si copa metali,  
Dhe Koperniku të vijë i qeshur,  
Me të të lundrojmë.  
Yjet, që duken sikur natën përpijnë,  
Sekstani<sup>1)</sup> yt i përpin, o detar,  
Tubë i Galileut i përpin  
Dhe ti, si lundërtar,  
Kursin mes detit shtrin.

### III

I tillë je, detar:  
I lirë, si dhe liriya vetë,  
Trim dhe i shpejtë si vetëtima,  
Sypafjetur dhe krenar,  
Bir i këtij trolli,  
Që lind veç trima.  
I tillë je, detar  
I pamposhtur si dhe Genci plak,  
Që mbrojti këtë breg të larë gjak.

### IV

Detar i udhëve të detit dhe të yjeve,  
Mbrotës i lirisë së përgjakur!  
Ti je vëllai i dëshmorit Çelnik,<sup>2)</sup>  
Shok i Spiros,<sup>3)</sup>

*Shënim:*

---

1) Sekstan — aparat optik.

2) Çelnik Hoxha — kapter i Flotës Luftarake Detare,  
rënë dëshmor në krye të detyrës.

3) Heroi i popullit Spiro Kote.

Ti je shqiponjë  
Në ballin e përflakur,  
Të flakëron  
Ylli i lirisë që ti mbron!

Mirseardhe detar i Republikës,  
Ti që lundron mbi faqet, flokët e thinjura të  
detit,

Ti ndjen frymëmarrjen e thellësive,  
Ty të thërrasin gjithnjë lundrimet  
Tek ky, i madhi det,  
Ndaj kënga ime le të buçasë për ty,  
Ashtu si dallga buçet.

## PËR TY BËJ ROJE

I qetë deti. Përmbi valë  
Rrëshqet anija ndër lundrime.  
Ja, mbi kuvertë un' kam dalë  
E përshëndes rivierën time,  
E përshëndes rivierën, brigjet,  
Ku portokajt çelin plot erë;  
Nga malli zemra po më digjet,  
Të falem ty, o moj rivierë!  
Të falem ty, rivierë e artë,  
Lundron anija, të le pas,  
E tres shikimin tim të zjarhtë  
Mbi ty, dhe zemra rreh plot gaz,  
E tres shikimin, dhe më ngjan  
Sikur peizazhi yt më ndjek.  
Tej mbetesh, ti, tej, në liman,  
Tej mbetesh ti, i shtrenjti breg.  
Për ty bëj roje, për atdhenë,  
Zjarr i partis' më vlon në gji  
Kur netve ti dhe brigjet flejnë  
Un' vigjiloj me sy shkëndi.  
Ylberi çel gjithnjë n'pranverë  
Ç'peizazh i këndshëm natyror!  
Të falem ty, o moj rivierë,  
Parajs' e këndit arbëror!



## A TË KUJTOHET, VËLLAI IM FSHATAR?

### I

A të kujtohet ty sot, o vëlla,  
Si misri yt që zverdhur nëpër arë  
E toka jote ishte bërë gur,  
Pështyma ty në fyt të ishte tharë?  
Për ty nuk kish as ujë, as shi dikur.  
Po, të kujtohet, vëllai im fshatar,  
Si beu vadiste në arë çdo pëllëmbë,  
Si lumë i derdhej uji nëpër arë.  
Ndaj misr' i tij të çante si me dhëmbë.

### II

Ti more shatën, drejt ujvarit shkove,  
Nuk pe ku pritë ty të kishin zënë.  
Ti nëpër mjegull fëmijët dëgjove:  
«A do na sjellë, babi bukë, nënë?»  
E preve ujin dhe me të u sule  
Tek ara jote, kur po digjej dheu.  
Ti sikur thikën beut ja ngule,  
Ty të shikonte hakëruar beu.



Ti zhurmë hapash, tmere ndjeve pranë;  
Të zunë, vlla, të lidhën me litarë  
Dhe me kamzhik në kokë ty të ranë.  
Vadite ti me gjak tokën e tharë  
Gërthiste beu, si gymyr qe nxirë,  
Kur ty, vëlla, të shtynë në ahur,  
Të rrahën ty xhelatët pa mëshirë,  
Ti ujë bërë, misri djegur zhur.  
Të rrahën ty tri ditë dhe tri netë,  
Si misri shpirti ty të qe zhuritur;  
Kudo të thirri gruaja jot' e shkretë  
Dhe vocërrakët qanin të uritur.  
Sa shpresa të buzqeshën, ç'ëndrra pe?  
Në djep të birit tënd përkunde ti  
Gëzimin e pafund, botën e re.  
Që kokën po i shtvpte beut t'zi  
Plot ëndrra pe në burg ti, o vëlla.  
Si zoçkë të erdhi vaiza në errësirë,  
Një dorë kumblla djalka ty të dha,  
Një dorë kumblla që s'ishin pjekur mirë,  
Që ti të lagie fytin e tharë,  
Dhe prap' kasolles tënde ti t'i shkoje  
Që të vadisje atë copëz arë,  
Fëmijët edhe gruan t'i gëzoje.

### III

Të nxorën ty në shesh të fshatit lidhur,  
Të rrahën prap' xhandarët, por qëndrove...  
Ti ike përmes dhëmbjes aq të hidhur  
Në brazdat e misrit prap' kalove.

Ti ece, oh, sa vapë! oh, sa vapë!  
Kasollja ty të priti dhe fëmijë,  
Ç'u dhe përveç gëzimit aq të paktë,  
Kur duart t'i vështronin ty kër.hinjte?..  
Ç't'u jepje, kur ti s'pate për të dhënë  
Përveç buzqeshjes heshtur si në varr?  
Me mijra kish at'here të pangrënë  
Si ti dhe fëmijt' e tu, vëlla fshatar.  
Sa vallë ti lërove nëpër arë!  
Sa vallë korre ti mes vapës-zhur!  
Ti barkun bosh dhe beu plot hambarë  
Dhe shpirtin ty të shtypte gjithnjë gur.  
E çfar' s'të bëri beu, çfar' s'të mori  
Të mori ty dhe arën pa vaditur,  
Mbi shpinën desh të shijë si kalë horri.  
Krenar ti sot, se tënden e ke tokën,  
Veç hallet mos harro, ndër mend i sill.  
Nuk di me këto vargje që kam shkruar  
A hyra në zemrën tënde, o fshatar.  
Ti sot punon i lirë, i bashkuar  
Dhe un' qëndroj në roje si ushtar!

## YJET KRYEULUR!...

Yjet kryeulur sa ëmbël sodisin,  
Si pasqyrë detin seç e llamburisin,  
Kurse harmonika... diku seç ja thotë  
Ç'i derdh prozhektori sinjalet mbi tokë.  
Tej duket Sazani, posi qafë kali,  
Në dyrek t'anijes pulëbardha ndali.  
Vrojton me detarët ajo në hapësirë,  
Që kurrë... mos shkelet bregu yn' i lirë!

## BRROMP MOSHATARË!

Brromp moshatarë!  
Mes rrugës sonë t'i përpjekim gotat;  
Kur rreshti ynë të jetë i pandarë,  
Le të vërtiten sado të egra shqotat.

Brromp moshatarë!  
Kjo është Shqipëria jonë,  
Mes zjarresh partizane ajo marshon,  
Me ballin lart dhe rrugën e ka çarë,  
Mbi shekujt e pazmbrapsur, moshatarë.

Brromp moshatarë!  
Mbi kokët tona rreze të kuqe bien,  
Me thinjët tona përzihen  
Dhe ecim ne, o shokë,  
Më shpejt nga shekujt nëpër tokë.



## SHTURMANIT

Ti yjet s' dalloje, jo, dikur,  
I shihje porsi xixat nëpër terr,  
Por ti tashti e njeh yllin Merkur  
Dhe ç'largësi ka plaku Jupiter.  
N'univers sa yje ka, pedhot 1)  
Por ti veç njerën sekstan rrëmben,  
E ul mbi detin plak me dallgë plot,  
Të saktën rrugë anijes ja gjen.  
Mes detit dhe yjeve sot je ti,  
Në hartë kordinata plot vizon  
Dhe kursin e drejton për në veri.  
Shturman, ti je në anije — astronom.

---

1) pedhot — shturman



## KËNGË PËR DËSHMORET

Ti ushto, moj elegji e thjeshtë,  
Ulu puthi këta varre ti,  
Derdh mbi ta aromë dhe lëng pjeshke  
Elegji, moj trimja elegji,  
Se po flejnë, moj, vëllezërit tanë,  
Se po treten ata nënë dhe.  
Lart u ndrisin yjet partizanë  
Era, shiu trupin ua rreh.

Le të fryjë era sa të dojë  
Le të bjerë shiu me tërbim,  
Ata gjokset i patën tebojë  
Mbi ta koha mbiell gjelbërim.

Ti ushto, moj elegji krenare,  
Ata pushkët zbrazën për liri.  
Ulu puthi bijtë nëpër varre,  
Ti këndo për ta moj elegji,  
Ata ranë, amanet na lanë  
Që t'i mbajmë pushkët përmbi krah,  
Flejnë, flejnë bijt' partizanë  
Roje bëjmë ne tani për ta!

## DETET

Detet e kaltër, detet e qetë,  
Stuhira, dallgë çojnë përperjetë,  
Detet e hapin gojën, po s'flasin:  
Detet fëmijve 'të mitur u ngjasin.

Në paralele detet janë ndarë  
Dete të shumta mbi glob un' kam parë,  
Dete 'të ftohtë, dete të ngrohtë,  
Detet t'i lagin brinjët, o botë.  
Detet me dallgë lëkundin lubira,  
Detet në gjire fshehin 'çudira.  
Detet i dua, detet këndoj  
Edhe në qiell dete vështroj;  
Detet ushtojnë dallgë përjetë,  
Dhe detet kanë: zemër dhe jetë!

## DHE HESHTUR VDIQ DJALOSHI

Përpara se ta vrisnin  
«Trego», ata i thanë, —  
«Kush zjarr i vuri depos,  
Kush shokët e tu janë?»  
Ai krenar qëndronte  
Dhe s'fliste asnjë fjalë,  
Mbi kokë retë e zeza  
Notonin porsi valë.  
Djaloshit gjak i rridhte  
Nga balli si rrëke,  
Në pranga shtërngon grushtet  
Dhe kokën lart e ngre.  
Atëhere kuestori  
Qëlloi prap' me kamzhik:  
«Ty jeta nuk t'u dhimka  
i kuqi heretik?»  
Djaloshi nuk përkulej,  
Qëndronte gjith' krenar,  
Në zemër kish Partinë,  
Në gjak-çelik e zjarr.  
Pastaj drejt tij u shkrehnë  
Plot tmer tytat fashiste.

Mes plumbash thirri: «Rroftë  
Partia Komuniste!»  
Dhe heshtur vdiq djaloshi,  
I lidhur me zinxhirë,  
Se deshte tokën mëmë,  
Se desh të ish i lirë.



## KRAHËT PËRPLAS NJË ÇAJKË MBI DIREK

Krahët përplas një çajkë mbi direk,  
Si val' e lirë  
Krahët po shkund.  
Krahët e dliirë, sa dua që t'ja puth  
Siç putha bregun dhe detin e pafund!

Ti krahët rreh, moi çajkë, mbi direk,  
Duke kënduar po vjen me ne,  
Se s'ka liri, për ty në tjetër breg;  
Liria, kënga, në bregun tim të pret,  
O pulëbardh' e lindur te ky det.

## PËR ATA QË JANË NË DET

Prapë udha më nxjerr ndër detet.  
Ja, ajo më sjell vërdallë larg,  
Prapa meje, toka mëmë mbetet,  
Kurse dallgët ulurijnë varg;  
Dhe bustinën seç ngjesh në kokë,  
Era grushtat ballit m'i përplas;  
Si Anteu marr fuqi nga toka,  
Toka ime kudo më ndjek pas.  
Si detar, unë thyej edhe hekur  
Udhës kaltër, ndaj eci me vrap.  
Zër' i çajkës përdridhet i mekur  
Përmbi shkumë, porsi mbi një trap.  
O moj çajkë, çajkë pëndëbardhë,  
Ti më derdh në kokë kaltërsi.  
Përmbi sup m'u ule këtë radhë,  
Që mos mbytesh detit me stuhi.  
Eja çajkë me anijen-hekur,  
Un' lundroj dhe kur fryn rrebes!  
Me rrebeshe, dallgë shpesh jam ndeshur  
Dhe në det piratë mbyta shpesh.  
Nuk kërkoj, jo, te ky det i gjerë,  
Si Kolombi, të gjej tjetër breg,  
Token mëmë unë mbroj përherë,  
Për Atdhe, dhe zemrën e djeg.

## II

Unë velat përherë i mbaj ngritur  
Nëpër dallgë, shkumë gjurmat lë,  
Mos kërkoni vargje të stolisur,  
Kur me vargje detin çaj gjithnjë.

## III

Dhe në jam pakëz «romantik»,  
Se bardhoshen çajkë dashuroj,  
Ti, o det, e di, me çdo armik  
Unë mes teje ndeshem dhe fitoj.  
Ke lëkundje dhe shpërthim tërmeti,  
Dhe tërmeti mposhtet me tërmet.  
Ti detarët shumë mirë i njuh,  
Shpirti yt me ta sa shpesh që flet,  
Se, kur supet si mal ti i ngre,  
Si feniks anija tej rrëshqet.  
Kot gërthet, o det, porsi i marrë!  
Ç'i nxjerr dhëmbët si çakall mbi hën?  
Ja, mes shqotës tënde, shih detarë  
Si timonin dhe pushkën shtërngon.

## IV

Vigjilohmë netëve, errësirë,  
Tejpërtej me sytë dritë plot,  
Kur na fton n'alarm bregu i lirë,  
Ne thërresim: «Gati, na ke zot!»





## NE ISHIM VULLNETARË DHE USHTARË

### I

Nuk kam ndërmend t'ju flas në këngën time  
Për lule apo vasha si peri,  
Un' do të flas për vitet plot gjëmime,  
Kur ende plagë lidhje, Shqipëri!

Po, do të flas e nuk do rri në heshtje,  
Se epopeja lehtë kurrë s'nis,  
Triumfet sapo korrëm në përlëshje,  
Mes plumbash nisëm Rrugën e Rinisë.

Të nisëm ty, o Rruga e Rinisë  
Të zbathur, të pangrënë, në acar,  
Në shpirt na ngrohte prushi i Partisë,  
Ndaj vrulli ynë pati aqë zjarr.  
I çajtëm ne shkëmbinjtë pors i thikë,  
Buçiti fush' e Muhrit<sup>1)</sup> «Urra!»  
E, që të mbronim ty, o Republikë,  
Ne pushkët mbanim hedhur përmbi krah.  
Se ti, o Republikë, sa kishe lindur,  
Preludi yt na ndriti drejt në sy  
Dhe djajtë dhe shkëmbinjtë e pabindur  
I shtypëm dhe të ngritëm lart ne ty.

Shkëmbinjtë ne i bëmë copa-copa  
Na rritej këng' e punës gjith' në gji  
Dhe mbushej shpirti gërxheve plot gropa,  
E çelej rruga Kukës-Peshkopi.

## II

Një natë retë nxinin përmbi shpate.  
Kur sulmi ynë vlonte nëpër shkrep,  
Ca krisma oshtinë në shtërngatë,  
Çelniku, shoku yn', në vend u step,  
Çelniku ra mes qiellit të përflakur.  
Drejt krismave u sulëm, morëm hak,  
Kur retë ecnin shpateve të plakur,  
Kur balli i shokut ishte mbytur gjak.  
Me gjak në gjoks, me gjak edhe në ballë  
E ulëm shokun mes dhimbjes në varr.  
I thamë lumit: «Drin, o perçebardhë,  
Ti mos harro si ra ky vullnetar!»  
Ne ishim vullnetarë dhe ushtarë,  
Se ishte vit' i dytë ai, Atdhe,  
Që ti përmbysje kull' e bajraktarë  
Dhe ti n'alarme shpesh na ftoje ne.  
Dhe zbrazëm pushkë ne duke punuar,  
Porsi shkëmbinjtë i flaknim mu në Drin  
Çakejtë që sulmonin t'urëtuar.  
Hakmarrja zjarr na ndiste për ndëshkim.  
Të tillë ishim, pa ngrënë dhe pa gjumë.  
Si zogjt e etur rrugës për stuhi,  
Përmbi shkëmbinj mësonim aqë shumë,  
Përmbi shkëmbinj ne mirrnim dituri.  
Nuk kishim ne as laps dhe as letër  
Nëpër shkëmbinj i shkruanim A dhe B-e.

Thërrisnim ne: «Shikonani, o etër,  
 Çfarë hovi ka rini e Botës re».  
 Kështu gjithnjë zëri na buçiti  
 Rreth zjarrit partizan e në çdo shpat  
 Kështu, në sulm, një këngë shpesh na ngriti,  
 Kjo këngë na u bë në shpirt pllakat.  
 Kjo këngë ish e kazmës, e lopatës  
 Kjo këngë shkriu me afsh dhe çelik,  
 Ndaj dhe në shi, edhe në mes të vapës,  
 Ne ecëm të padhënë më me vrik.  
 Si zhurmë minash ish kjo kënga jonë,  
 I trembi zanat, ujqit për gjithnjë  
 Dhe malësorët, ashpër si gjithmonë,  
 «S'do kemi, — thanë, — bajraktarë më».  
 Dhe bajraktarët kokat i vërtisnin,  
 Dhe kullat linin zbrisnin nëpër rrah  
 Na zinin prita, deshën të na vrisnin,  
 Po ne qëllonim ashpër për mbi ta.

### III

Dëshira! Sa dëshira na shpërthenin  
 Kur kazmat oshtinin në taban,  
 Kur rrugën Republikës ne i çelnim  
 E suleshim për emërin partizan.  
 Kur çanim edhe majën më të lartë  
 Thërrisnin malsorët: «Hej, heu!  
 I tundi bjeshkët kjo rini e zjarrtë,  
 Kamioni do na vijë bash, këtu».  
 Kur ëmbël ne na thoshin malësorët:  
 «I bani, o sokola, bjeshkët shesh».  
 Ne hidheshim shkëmbinjve si kalorës,  
 Shkëmbinjte ulnin kryet para nesh.



Kur sa me zjarr në mbledhje diskutonim,  
Kur ndonjë punës shpejt i bënte bisht  
Dhe kur anëtar' e BRASH-it e pranonim  
Te garda e jonë, të ri komunist,  
Kur çanim edhe shkrepja, shtrinim pyje,  
Kur vinim nëpër vrima dinamit,  
Kur ecnim nënë re dhe nënë yje  
Dhe vrulli nuk na thoshte kurrë «prit».  
Kur hiqnim valle ne me malësorët,  
Kur çelën malësorët syt' e zez.  
Na vinin rrotull malet me dëborë,  
Shkëndi e miqësis' më tej u ndez.  
Kur erdhi malësorja vullnetare  
Ja puthi gushën dielli rreze-ar,  
Kur qeshi malësorja sa krenare  
Dhe shkrepën syt' e sajë tërë zjarr,  
Kur thoshim: «Mbas ca vjetësh Shqipëria  
Do bëhet vend i bukur madhështor.  
Do ketë shkolla, dritë malësia!»  
Të ardhmen pagëzo, o malësor.  
Kur thoshin malësorët: «Çfar' petritash  
Që qenkan vullnetarët në malsi,  
Me kazma dhe me pushkë nëpër prita  
E zjarrtë dhe e hekurt kjo rini!»  
Kur zbrisnin malësorët buzë Drinit  
E vijshin malësorët vrik te ne,  
Sulmonin malësorët, minat vinin  
E çelej mes betejash rrug' e re.  
Dhe ecte rreshti ynë gjith' përpara,  
Si zanat dhe si shqipet fluturim  
E rridhte djersa jonë nëpër gara,  
E rëra shtrohej rrugës si qilim.  
Sulmonin vajzat tona duararta,



Një këngë ia thosh shpesh një devulli.  
Dëshira! Çfar' dëshira, sa të zjarrta,  
Na vlonin për ty, nëna jonë Parti!  
Ne ishim vullnetarë dhe ushtarë,  
Se lehtë epopeja jonë s'u nis,  
Ne ishim një armatë e pandarë  
Mes plumbash çelëm Rrugën e Rinisë.  
U muar ky fragment n'ato vite,  
Si një vegim ka ecur gjer më sot.  
Tashti mes vrullit t'madh po përtritet  
N'aksione shkon rinia gëzimplot!

---

1) Në fushë të Muhrit, në qershor të vitit 1946, filloi Rruga e Rinisë Kukës-Peshkopi.

## KËSHTU E VRANË TIM VËLLA

Kështu e vranë tim vëlla, pranë një plepi.  
Kapën i dhanë,  
«Shkele yllin» i thanë.  
Por im vëlla të qeshurës ia shkrepri,

Kapën në kokë e vuri.  
Kuestori si bishë u hodh përpjetë,  
Kapën ia flaku ndër këmbë,  
«Shkele!» i tha  
Dhe e qëlloi ndër dhëmbë.

Prap' qeshi im vëlla.  
Ndërsa po shihte nëpër ëndërr  
Një ditë më të re,

Krisi një batare.  
Ra im vëlla, ashtu i buzëqeshur,  
Duke vështruar nga qielli, nga pylli,

Dhe sikur thosh:  
«Fashist, e ke gabim  
Nuk shkelet kurrë ylli».

## BALLADË PËR DETARIN

Po fle trimi nënë valë,  
Nënë det po fle ai,  
Yjt' i ndrisin përmbi ballë,  
Përmbi varr' i çfryn stuhi.

Yjt' i ndrisin që nga lart,  
Yjtë, valët si ylber,  
Me të fle dhe mall' i zjarhtë,  
Por kujtimi rron përherë!

Veç atje ku ra detari,  
Obelisk të ngritur s'ka,  
Atje afër i ndrit fari  
Dhe një shkëmb ngrihet — kala.

Në ato çaste, trim i rënë  
Si dragua përshëndet  
Gjith' të gjallët, tokën nënë,  
Mjekërkaltëroshin det.

Fle detari nënë valë,  
Sytë si i kuq fanar,  
Përmbi shkëmb hedhin stërkalë  
Dhe shkëlqimin mu në far.

Rron kujtimi i tij, lavdia,  
Porsi deti me tallaz,  
Dhe të vdekur Shqipëria  
Bijt' e saja i ka pas!



## AT' E BIR

(Balladë)

Haxhi Alia me të birë  
Porsi mbreti me vezirë...

Dit' e errët, frynte erë,  
Deti ngrihej hon,  
Një lubi me plot potere  
Tej valëve lundron.  
O moj ti, lubi pirate,  
Ç'djall të sjell tek ne?  
Ti s'i del kësaj shtërngate  
Shpëtim, jo, nuk ke!  
Se aty rrëzë Sazanit  
Rron trimi Haxhi,  
Që s'i trembet, jo, tufanit  
Dhe ty, moj lubi!  
Ja, i biri që vrojtonte,  
I tha: «Ati im,  
Një anije me piratë  
Po vjen me tërbim...»  
Shikoi plaku tej nga deti  
Dhe i shkau një lot.

«Le të fryjë, — tha, — kiameti,  
Do lundrojmë sot».  
Puthi djalë e Sazanë  
Heshtazi, në ças,  
Dhe u nis-o me Tartanë  
Valëve plot tallas.  
Deti ngrihej edhe ulej  
Tmershëm porsì hon,  
Haxhi trimi me armiqtë  
Fytafyt lufton.  
At' e bir seç po luftojnë,  
Gjaku rrjedh në det.  
«Hej, armiq, do t'ju coptojmë!» —  
Haxhiu po thërret.  
Bregut mjegulla noton  
Dëndur, porsì re.  
Shpat' e tija vringëllon,  
Mbi armiqtë rreh.  
Dhe e vrau-o kapitanë  
Armikun e zi.  
«Kështu mbrojmë ne vatanë» —  
Tha trimi Haxhi.  
Dhe pareshtur ulqinaku  
Shpatën rënd' e ngre,  
Gjersa jetën edhe gjakun  
Fal për ty, Atdhe!  
Ai ra duke luftuar.  
Porsì një direk,  
Valët qanin turbulluar  
Ngriheshin si breg.  
U vra baba, por i biri  
Mbi armiqt' merr hak,  
Kokn' vet' ja pret inglizit,

Shpatat mbyten gjak;  
E me hov ai armiqtë  
Në betej' i shtrin,  
Deti perçet ngreh përperjetë  
Zjen e ulurin.  
Thyen velat e direktët,  
Thyhet dhe një bort;  
Frikë s'ka djal' i Haxhisë,  
Ndaj lufton pa mort.  
Fluturonin çajkat lehtë,  
Dallgët linin pas,  
Diell' i skuqur zbret nga retë,  
Mbytet në tallas.  
«Pse, piratë, mbani shpresë? —  
Flet djali hero. —  
Deti kockat do ua tresë,  
Rrug' e fundit kjo».  
«Ej, shqiptar, ti je i vrarë.  
Fati yt u pre;  
Në fund t'detit e ke varrë,  
Valët qefin ke».  
«Le të vdes, o në furtunë, —  
Gjegjet ai bir, —  
Se Sazan, Karaburunë  
I mbrojtëm me hir».  
Dhe shtërngatës ai mbeti  
Nga armiqt' e zez,  
Ballin rrudhur vajtoi deti,  
Por lavdia s'vdes.



	Faqe
Atdheu im .....	3
Kënga ime .....	4
Ti të jeshë me mua një ushtarë .....	6
Lundrim të mbarë! .....	8
I tillë unë tek ju fshatarë vij .....	10
Shkëmbit arbëror .....	11
Peizazh detar .....	12
Që të mos plakesh ti, o Shqipëri .....	14
Të dua, det .....	15
Nëndor i madh .....	16
Në ëndërr .....	17
Rinia ime .....	18
Stuhia e detit .....	19
Gazmore .....	20
Ti detarëve rrugën u ndriçon .....	22
Këngë për detarin .....	23
Për ty bëj roje .....	26
A të kujtohet, vëllai im fshatar? .....	27
Yjtë kryeulur .....	30
Brormp moshatarë .....	31
Shturmanit .....	32
Këngë për dëshmorët .....	33
Detet .....	34
Dhe heshtur vdiq djaloshi .....	35
Krahët përplas një çajkë në direk .....	37
Për ata që janë në det .....	38
Ne ishim vullnetarë dhe ushtarë .....	41
Kështu e vranë tim vëlla .....	46
Balladë për detarin .....	47
At e bir (balladë) .....	49